

**KONTRATË SHITJE KUOTASH TË KAPITALIT TË SHOQËRISË**  
**"Astronaut Trip Albania" Sh.p.k**

Sot me datë **28/09/2020** (dymjë e njëzet), u lidh kjo kontrate midis palëve:

**Klajd Kruja**, atësia Xhavit datëlindja 02.08.1978, lindur në Tiranë, banues në adresen "Asim Vokshi"; Nd. 0; Njësia Administrative Nr. 9; Njesia bashkiake nr. 9; 0000; Tiranë, shtetas shqiptar, mbajtës i Kartës së Identitetit Nr.personal H80802117D.  
(këtu e më poshtë referuar si **Shitësi**).

**Boiken Lako**, atësia Bujar, datëlindja 25/05/1975, lindur në Tirane dhe banues në adresen "Hajdar Hidi", Nd. 62, H. 2, Ap. 14; Njësia Administrative Nr. 10; Njësia Bashkiake Nr. 10; 1001; Tiranë, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, shtetas shqiptar mbajtës i kartes se Identitetit Nr.personal H50525071C.

(këtu e më poshtë referuar si **Bleresi**)

**Baza Ligjore** : Dispozitat e Kodit Civil

Ligji 9901 dt. 14.04.2008 « Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare »

Ligji 9723 dt. 03.05.2007 « Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit »

**Kushtet paraprake**

A) Shoqëria me perjegjesi të kufizuar "**Astronaut Trip Albania**" Sh.p.k. është rregjistruar si person juridik me No. NIPTI M01506011F, me kapital themeltar **200.000 (dyqindmijë) lekë**, Klajd Kruja-1,00 pjesë të barabarte me 100,00; administrator i shoqërisë është Klajd Kruja, shoqëria ka seli në Tiranë, Rruga:"Fortuzi", Nr. 22, Ap 1.

B) Shitësi, ka vendosur të shesë një pjesë të kuotës së tij që disponon në kapitalin themeltar të **Shoqërisë** dhe Blerësi është i detyruar të paguajë për to shumën e rënë dakort sipas kushteve dhe termave të kësaj Kontrate.

C) Të drejtat e pronësisë mbi kuotat e shitura kalojnë nga shitësi tek Blerësi në momentin e pagesës së plotë të çmimit të shitjes, moment që përputhet edhe me nënshkrimin e kësaj Kontrate nga Palët. Bashkë me të drejtat e pronësisë mbi Kuotat, Blerësi do të blejë të drejtat e Pjesmarjes në Shoqëri njëkohësisht edhe **detyrimet** që mbartin këto kuota bazuar në parashikimet e ligjit dhe aktet themeluese të Shoqërisë.

D) Palët duke marrë parasysh sa më sipër, pranojnë të lidhin këtë Kontratë shit-blerje të kuotave (në vijim «**Kontrata** ») sipas kushteve të mëposhtme :

**Neni 1. Çmimi i kuotave dhe procedura e kryerjes së pagesës**

1.1 Nëpërmjet kësaj Kontrate **Shitësi Klajd Kruja** merr përsipër të shesë dhe transferojë tek Blerësi **Boiken Lako** 1 kuotë/pjesë të tij të barabartë me 50,00 perqind të kapitalit, kundrejt **çmimit 100.000 lekë**.

1.2 Blerësi **Boiken Lako** pranon të blejë nga Shitësi **Klajd Kruja** 1 kuotë/pjesë të barabartë me 50,00 perqind të kapitalit kundrejt **çmimit 100.000 lekë**.

1.3 Palet deklarojne se çmimi i shitjes prej kundrejt **çmimit 100.000 lekë** është likujduar i plotë nga ana e blerësit.

1.4 Me nënshkrimin e kontratës dhe me likujdimin e plotë të çmimit të shitjes në total prej kundrejt **çmimit 100.000 lekë** kalon edhe pronësia nga shitësi **Klajd Kruja** tek blerësi **Boiken Lako** duke u bërë tashmë shoqëria "**Astronaut Trip Albania**" Sh.p.k shpk me dy ortakë :

Klajd Kruja zotëruesh i **1/kuote/pjesë**, të barabarta me 50,00 perqind të kapitalit me vlerë **100.000 lekë** dhe **Boiken Lako** 1,00 Kuotë/pjese të barabarte me 50,00 perqind të kapitalit vlera 100.000 leke



## Neni 2. Deklarime dhe Garancitë e Shitësit

- 2.1 Shitësi deklaron dhe garanton se është e vetmi pronarë dhe titullarë të ligjshëm të kuotave dhe i të drejtave që rrjedhin prej tyre.
- 2.2 Shitësi deklaron dhe garanton se kuotat janë të lira nga çdo peng, privilegj, barrë apo çdo e drejtë tjetër në favor të të tretëve, pa kufizime për tjetërsimin e tyre, kuotat nuk janë objekt i ndonjë mosmarrveshje, dhe nuk janë të pezulluara.
- 2.3 Shitësi deklaron dhe garanton se Shoqëria është themeluar dhe operon rregullisht në bazë të legjislacionit shqiptar dhe në bazë të akteve të shoqërisë, ka të drejtë të plotë për të ushtruar aktivitetin e saj në përputhje me aktin e themelimit dhe statutin që rregullon funksionimin e saj.
- 2.4 Shitësi deklaron dhe garanton se Shoqëria nuk është në proces falimentimi, likujdimi të vullnetshëm ose jo apo në ndonjë proces të ngjashëm.

## Neni 3. Garancitë e Blerësit

- 3.1 Blerësi deklaron se e njeh statusin faktik dhe ligjor të Shoqërisë.
- 3.2 Blerësi e nënshkruan rregullisht këtë kontrate e cila është e vlefshme, e ligjshme dhe e detyrueshme për zbatim nga ana e Blerësit.
- 3.3 Blerësi ka kryer të gjitha veprimet, ka marrë të gjitha masat për përbushjen e të gjitha detyrimeve sipas kësaj kontrate.
- 3.4 Administratori Klajd Kruja do të ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore për të paraqitur këtë kontratë në QKB, me qëllim regjistrimin e ndryshimeve respektive ..

## Neni 4 Zgjidhja e Mosmarrveshjeve

- 4.1 Palët angazhohen të zgjidhin me mirëkuptim çdo mosmarrveshje që lidhet me interpretimin dhe ekzekutimin e kësaj Kontrate.
- 4.2 Nëse nuk arrihet një zgjidhje me mirëkuptim, mosmarrveshja do te zgjidhet ekskluzivisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

## Neni 5 E drejta e zbatueshme


- 5.1 Kjo kontratë dhe te drejtat e detyrimet e Palëve do të disiplinohen dhe ushtrohen në bazë të së drejtës shqiptare.

## Neni 6 Vlefshmëria

- 6.1 Kjo kontratë është e vlefshme me nënshkrimin e saj nga palët.
- 6.2 Kontrata hartohet në 3(tre) origjinalë.
- 6.3 Palët pasi e pranuan sa është shkruar në Kontratë, e nënshkruan si më poshtë rezulton, një nga të cilat për ta paraqitur në QKB për të bërë të mundur rregjistrimin e ndryshimeve përkatëse, një për Shitësin, një kopje për Blerësin.

Palët

Shitësi  
Klajd Kruja

KLAJD KRUA  


Blerësi  
Boiken Lako

